VENDIM
Nr.80, datë 26.6.2008

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFËS PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9, 26 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22. 5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.35, datë 21.3.2008 "Për fillimin e procedurave të miratimit të metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit, metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike, metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike dhe metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike", Bordi i Komisionerëve në mbledhjen e tij të datës 26.6.2008, pasi shqyrtoi draftin e metodologjisë së paraqitur,

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike. (Metodologjia bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta